

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Vila e dytë në bregdet - Sekuestrohet vila 410 mijë euro në Palasë e Belinda Ballukut, Igli Tare
ADRESA	https://www.syri.net/kronike/915496/sekuestrohet-vila-410-mije-euro-ne-palase-e-belinda-ballukut-igli-tare-prestanome-i-shtohet-akuza-korrupsion-dhe-pastrim-parash/
BURIMI	syri.net
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	9 shtator 2026, 16:58:17 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	9 shtator 2026, 15:34:51 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	1ff74a4dca51a910156ede712eed282a0d413c10f9e6bacecc9ab2600ce3ee87
TEKSTI	efc36ba06270ee41a5dae2a61ae0f5c005985133dad3cbe991b631f94f69f155
PAMJA	2bbc756a56775298368bc0d93e13ab475f97d6b02c016083e6f9440e977d7bdb

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	7aca743c1ebd6b3b54a7207346a5cabbe8f7ecc8c4e3143e17c7a5daf216f7f5
E MËPARSHMJA	5173995dcf45fec44f7f8e39af0788059cbfb83cc9400bfd922b235c36174
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/7aca743c1ebd6b3b54a7207346a5cabbe8f7ecc8c4e3143e17c7a5daf216f7f5>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored · dritarja 1280×1024 px

- [Për ne](#)
- [Redaksia](#)
- [Marketing](#)
- [+355697009690](#)
- [Edicioni i Kosovës](#)
-
- [Lajme](#)
 - [Web TV](#)
 - [Kuriozitete](#)
 - [Arte & media](#)
 - [Sociale](#)
 - [English](#)
 - [Shëndet](#)
 - [Tjera](#)
- [Politikë](#)
- [Kronikë](#)
- [Ekonomi](#)
- [Kosova](#)
- [Botë](#)
 - [Rajoni](#)
- [Kulturë](#)
- [Shkencë](#)
 - [Teknologji](#)
- [Sport](#)
 - [Botërori 2026](#)
- [Jetë/stil](#)
- [Trashëgimi](#)
 - [Histori](#)
- [Mjedis](#)
 - [Klimë](#)
- [Op-Ed](#)
 - [Analizë](#)
 - [Blog](#)
- [PLUG](#)
-
- [Marketing](#)
- [+355697009690](#)

toggle menu

 [Ndriçim Kulla Ndriçim Kulla Shogëria shqiptare, duhet të fillojë betejën me heshtjen e SPAK-ut](#)

 [Irena Beqiraj Irena Beqiraj Në Shtetin e Ronit!](#)

 [Sekuestrohet vila 410 mijë euro në Palasë e Belinda Ballukut, Igli Tare 'prestanome'! I shtohet akuza korrupsion dhe pastrim parash](#)

-
-
-
-

Sekuestrohet vila 410 mijë euro në Palasë e Belinda Ballukut, Igli Tare 'prestanome'! I shtohet akuza korrupsion dhe pastrim parash

ZMADHO TEKSTIN 17:34, 09/09/2026



Prokuroria e Posaçme SPAK ka sekuestruar një tjetër vilë që ish zv/kryeministria e Edi Ramës, Belinda Balluku e ka përfutur nga veprimet korruptive duke favorizuar kompani në prokurorimet e tenderave.

Bëhet fjalë për vilën, me sipërfaqe 478 m2 truall dhe 142.6 m2 ndërtesë në Nukli 27", në Palasë. Vila përbëhet nga sipërfaqe kati përdhe 142.6m2, sipërfaqe kati i parë 128.6m2, sipërfaqe nën parkim1 20.1m2, sipërfaqe nën parkim2 40.2m2)

Për të fshehur përfitimin e krijuar si produkt i veprës penale të korrupsionit, Balluku ka përdorur sërish bashkëpunëtorin e saj, ish futbollistin, Igli Tare.

"Për të fshehur këtë pasuri të padëklaruar, e pandehura Belinda Balluku ka përdorur shtetasin Igli Tare, duke kryer veprime fiktive nëpërmjet kontratës së sipërmarrjes, datë 26.10.2020, në shumën 250,000 Euro, vlerë që përfshinte investimin deri në ndërtimin e pasurisë në fazën e karabinasë" informon SPAK.

Në njoftim SPAK informon se ka thelluar hetimet dhe ka zbuluar fakte te reja penale per procedimin penal 136 të vitit 2025. Balluku është nën akuzë dhe për shkelje të barazisë në tenderin e 8-të, atë të "Ndërtimit të Unazës së Jashtme Tiranë, Loti 7", me fond limit 2.3 miliardë lekë, ndërsa i janë shtuar dhe akuzat korrupsion pasiv dhe pastrim parash i kryer në bashkëpunim.

Sipas SPAK në ndërtimin e Unazës së Jashtme të Tiranës Loti 7, rezulton se e pandehura Belinda Balluku, në cilësinë e Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, në bashkëpunim me titullarin e autoritetit kontraktor, shtetasin Evis Berberi, anëtarët e njësisë së prokurimit kanë krijuar avantazhe dhe privilegje të padrejta për operatorin ekonomikë fitues të kësaj procedure prokurimit, bashkimin e operatorëve ekonomikë "Alko-Impex General Construcion" dhe "2T" sh.p.k, të Arbër Abazi.

SPAK informon se nga aktet e administruara kanë rezultuar të prova për veprime të kundraligjshme të të pandehura Belinda Balluku, në lidhje me procedurën e prokurimit me objekt "Ndërtimi i Unazës së Jashtme Tiranë, Loti 7", me fond limit 2 353 597 373.94 (dy miliardë e treqind e pesëdhjetë e tre milionë e pesëqind e nëntëdhjetë e shtatë mijë e treqind e shtatëdhjetë e tre pikë nëntëdhjetë e katër) lekë pa tvsh.

"Në këmbim të favorizimit të shoqërisë "Alko Impex General Construction", në procedurën e prokurimit të sipërpërmendur, ka kërkuar dhe marrë nga shtetasi Arbër Abazi, vlerën e përfitimit të parregullt, në formën e investimeve/punimeve në objektin "Vila familjare 2F nr.188/1, Nukli 27", e ndërtuar në kompleksin "Green Coast", Palasë, Himarë.

"Ndërsa në vijim të ndërtimit të këtij objekti, investimi është marrë përsipër dhe realizuar nga shtetasi Arbër Abazi, pronar i shoqërisë "Alko Impex General Construction", pjesë përbërëse e bashkimit të operatorëve ekonomikë të shpallur fitues në procedurën e prokurimit me objekt "Ndërtimi i Unazës së Jashtme Tiranë, Loti 7". Sipas preventivit të punimeve të marra përsipër nga ana e shtetasit Arbër Abazi, vlera e këtij investimi varion nga 288,616 Euro deri në 410,526 Euro" thekson SPAK.

Çfarë përmban procedimi penal 136 të vitit 2025

A- "Shkelja e barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike", në bashkëpunim (e kryer tetë herë),parashikuar nga neni 258/2 e 25 të Kodit Penal, në lidhje me procedurat e prokurimit me objekt:

- 1."Ndërtimi i tunelit të Llogarasë" në seksionin rrugor Orikum-Himarë, pjesë e autostradës SH8(Vlorë-Sarandë).
- 2."Plotësimi rakordimi dhe vazhdimi i punimeve Sheshi Shqiponja – Lumi i Tiranës, Loti 1 dhe QMT".
- 3."Ndërtimi i segmentit rrugor Sheshi Shqiponja-Bulevardi i Ri, Loti 2".
- 4."Ndërtim i segmentit rrugor Sheshi Shqiponja-Bulevardi i Ri- Shkozë, Urat mbi lumin Tirana". 5."Ndërtimi i Unazës sëJashtme Tiranë, Loti 4".
6. "Ndërtim i Unazës së Jashtme Tiranë, Loti 5".
- 7."Ndërtim i Unazës së Jashtme Tiranë, Loti 6".

8. "Ndërtim i Unazës së Jashtme Tiranë, Loti 7";

B- "Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike", parashikuar nga neni 259 i K.Penal dhe "Pastrimi i produkteve të veprës penale apo i veprimtarisë kriminale", në bashkëpunim, parashikuar nga neni 287 paragrafi 1, gërma "b" të Kodit Penal, e kryer në rrethanën cilësuese "në bashkëpunim", sipas nenit 287, paragrafi 2, i Kodit Penal.

Njoftimi i SPAK

SPAK thellon hetimin dhe zbulon fakte të reja penale për procedimin penal 136 të vitit 2025

Prokuroria e Posaçme ka vijuar hetimet në kuadër të procedimit penal nr.136 të vitit 2025, për faktet penale në ngarkim të të pandehurës Belinda Balluku, për kryerjen e veprave penale:

A- "Shkelja e barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike", në bashkëpunim (e kryer tetë herë), parashikuar nga neni 258/2 e 25 të Kodit Penal, në lidhje me procedurat e prokurimit me objekt:

1. "Ndërtimi i tunelit të Llogarasë" në seksionin rrugor Orikum-Himarë, pjesë e autostradës SH8(Vlorë-Sarandë).
2. "Plotësimi rakordimi dhe vazhdimi i punimeve Sheshi Shqiponja – Lumi i Tiranës, Loti 1 dhe QMT".
3. "Ndërtimi i segmentit rrugor Sheshi Shqiponja-Bulevardi i Ri, Loti 2".
4. "Ndërtim i segmentit rrugor Sheshi Shqiponja-Bulevardi i Ri- Shkozë, Urat mbi lumin Tiranë". 5. "Ndërtimi i Unazës së Jashtme Tiranë, Loti 4".
6. "Ndërtim i Unazës së Jashtme Tiranë, Loti 5".
7. "Ndërtim i Unazës së Jashtme Tiranë, Loti 6".
8. "Ndërtim i Unazës së Jashtme Tiranë, Loti 7";

B- "Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike", parashikuar nga neni 259 i K.Penal dhe "Pastrimi i produkteve të veprës penale apo i veprimtarisë kriminale", në bashkëpunim, parashikuar nga neni 287 paragrafi 1, gërma "b" të Kodit Penal, e kryer në rrethanën cilësuese "në bashkëpunim", sipas nenit 287, paragrafi 2, i Kodit Penal.

Nga kryerja e veprimeve hetimore në vijim të hetimeve paraprake, të shoqëruara edhe me metoda speciale të hetimeve, si dhe nga mbledhja e provave dixhitale dhe provave të tjera, kanë rezultuar të dhëna për fakte penale të reja, nëngarkim të të pandehurës Belinda Balluku.

Konkretisht, nga aktet e administruara kanë rezultuar të prova për veprime të kundraligjshme të të pandehura Belinda Balluku, në lidhje me procedurën e prokurimit me objekt "Ndërtimi i Unazës së Jashtme Tiranë, Loti 7", me fond limit 2 353 597 373.94 (dy miliardë e treqind e pesëdhjetë e tre milionë e pesëqind e nëntëdhjetë e shtatë mijë e treqind e shtatëdhjetë e tre pikë nëntëdhjetë e katër) lekë pa tvsh.

Në lidhje me procedurën e prokurimit të sipërcituar, rezultojnë se e pandehura Belinda Balluku, në cilësinë e Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, në bashkëpunim me titullarin e autoritetit kontraktor, shtetasin Evis Berberi, anëtarët e njësisë së prokurimit, shtetasit Miranda Shkurti, Dhurata Lazaj dhe Nikollaq Mihali, anëtarët e komisionit të vlerësimit të ofertave, shtetasit Arbër Troka, Gëzim Noni dhe Arlinda Gordani, kanë krijuar avantazhe dhe privilegje të padrejta për operatorin ekonomikë fitues të kësaj procedure prokurimit, bashkimin e operatorëve ekonomikë "Alko-Impex General Construction" dhe "2T" sh.p.k, duke vepruar në kundërshtim me ligjin nr. 162/2020, "Për prokurimin publik", nenet 18, 19, 21, 42/2, 56, 76, 77, 80, 92, 95 të tij, me ligjin nr.9367, datë 07.04.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike", i ndryshuar, nenin 3 të tij, si dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", nenet 7 (pika 1, 2 dhe 9), 26, 27, 47 (pikat 2, 3, 4), 73, 82, 93, të tij.

Nga hetimi rezultojnë se e pandehura Belinda Balluku ka në pronësi faktike pasurinë e paluajtshme "Vila familjare 2F nr.188/1, Nukli 27", në kompleksin "Green Coast", Palasë, Himarë, e cila ka rezultuar se është një pasuri e fshehur.

Për të fshehur këtë pasuri të padeklaruar, e pandehura Belinda Balluku ka përdorur shtetasin Igli Tare, duke kryer veprime faktive nëpërmjet kontratës së sipërmarrjes, datë 26.10.2020, në shumën 250,000 Euro, vlerë që përfshinte investimin deri në ndërtimin e pasurisë në fazën e karabinasë.

Ndërsa në vijim të ndërtimit të këtij objekti, investimi është marrë përsipër dhe realizuar nga shtetasi Arbër Abazi, pronar i shoqërisë "Alko Impex General Construction", pjesë përbërëse e bashkimit të operatorëve ekonomikë të shpallur fitues në procedurën e prokurimit me objekt "Ndërtimi i Unazës së Jashtme Tiranë, Loti 7". Sipas preventivit të punimeve të marra përsipër nga ana e shtetasit Arbër Abazi, vlera e këtij investimi varion nga 288,616 Euro deri në 410,526 Euro.

E pandehura Belinda Balluku, për shkak të funksionit, Ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, në këmbim të favorizimit të shoqërisë "Alko Impex General Construction", në procedurën e prokurimit të sipërpërmendur, ka kërkuar dhe marrë nga shtetasi Arbër Abazi, vlerën e përfitimit të parregullt, në formën e investimeve/punimeve në objektin "Vila familjare 2F nr.188/1, Nukli 27", e ndërtuar në kompleksin "Green Coast", Palasë, Himarë.

Për të fshehur përfitimin e krijuar si produkt i veprës penale të korrupsionit, e pandehura Belinda Balluku ka përdorur sërish shtetasin Igli Tare, duke kryer veprime faktive të mëtejshme në lidhje me krijimin e dokumentacionit të pronësisë, për regjistrimin e kësaj prone në emër të shtetasit Igli Tare, sipas kontratës faktive të shitjes, datë 12.09.2025.

E pandehura Belinda Balluku, për shkak të detyrës, Ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, në bazë të neneve 3, pika 2, gërma "a", neni 7, pika 1, të Ligjit nr.9049, datë 10.04.2003, "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë" të ndryshuar, ka pasur detyrimin ligjor për deklarim të kësaj pasurie, por që nuk e ka bërë, me qëllim fshehjen e saj, nëpërmjet krijimit të dokumentacionit të pronësisë në emër të shtetasit Igli Tare.

Për faktet penale të reja në lidhje me pasurinë e paluajtshme "Vila familjare 2F nr.188/1, Nukli 27", e ndërtuar në kompleksin "Green Coast", Palasë, Himarë, rezultojnë se:

-E pandehura Belinda Balluku dyshohet se ka kryer veprat penale "Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose i të zgjedhurve vendorë", "Refuzimi për deklarimin, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive, interesave privatë të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë ose i çdo personi tjetër që ka detyrimin ligjor për deklarim", parashikuara nga nenet 260 dhe 257/a, të Kodit Penal, si dhe për veprën penale "Pastrimi i produkteve të veprës penale ose i veprimtarisë kriminale", parashikuar neni 287, gërma "b" të Kodit Penal, e kryer në rrethana cilësuese "në bashkëpunim dhe më shumë se një herë", sipas nenit 287/2 të Kodit Penal.

-Shtetasi Arbër Abazi dyshohet se ka kryer veprën penale "Korrupsioni aktiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose të zgjedhurve vendorë", parashikuar nga neni 245 të Kodit Penal.

-Shtetasi Igli Tare dyshohet se ka kryer veprën penale "Pastrimi i produkteve të veprës penale ose i veprimtarisë kriminale", parashikuar neni 287, gërma "b" të Kodit Penal, e kryer në rrethana cilësuese "në bashkëpunim dhe më shumë se një herë", sipas nenit 287/2 të Kodit Penal.

-Personi juridik "Alko Impex General Construction" (shoqëri e shtetasit Arbër Abazi) dyshohet se ka kryer veprën penale "Korrupsioni aktiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose të zgjedhurve vendorë", parashikuar nga neni 245 të Kodit Penal.

Pas kërkesës së paraqitur nga Prokuroria e Posaçme, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, me vendimin nr.591, datë 09.09.2026, ka vendosur:

-Kaktimin e masës së sigurimit pasuror "sekuestro preventive" mbi pasurinë e paluajtshme "Vila familjare 2F nr.188/1, Nukli 27", në kompleksin "Green Coast", Palasë, me të dhënat e pasurisë së regjistruar Zona Kadastrale 1739, me numër pasurie 68/87/73, Volumi 9, Faqe 148, me sipërfaqe totale 478 m2, prej të cilave 478 m2 truall dhe 142.6 m2 ndërtesë (me përshkrim të veçantë " sipërfaqe kati përdhe 142.6m2, sipërfaqe kati i parë 128.6m2, sipërfaqe nën parkim1 20.1m2, sipërfaqe nën parkim2 40.2m2).

Prokuroria e Posaçme vijon që të kryejë veprimet e nevojshme hetimore për këtë procedim penal, me qëllim sqarimin e plotë të rrethanave dhe fakteve penale që janë objekt i këtij hetimi.

Sqarim: Çdo person prezumohet i pafajshëm deri sa nuk vërtetohet fajësia e tij me vendim gjyqësor të formës së prerë.

© SYRI.net

Lexo edhe:

-  [Zjarri shkruan sipërfaqe të konsiderueshme me bimësi në Finiq](#)
-  [Shqiptarin e lidhën, e qëlluan dhe e hodhën në lumë/ Hetuesit: Pronari i makinës nuk denoncoi vjedhjen](#)
-  [SKANDALI/ Të arrestuarit 24 orë pa ushqim, morën çelësat e policëve dhe i kthyen vetëm pas negociatave për bukë](#)

Më të lexuarat

[Kronikë](#)

[SYRI TV/ Zjarri në Fier, 15 banesa të djegur, dëmshtëpërlimi për fermerët në pikëpyetje](#)

[Kronikë](#)

[Goditet një rast i shpërndarjes së lëndëve narkotike në Tiranë, arrestohet 27-vjeçari](#)

[Kronikë](#)

[**Sherri i armatosur te ‘Regina Palm’/ Bie pista e gjobëvënies, gjykata liron Luan Muçen**](#)

[Kronikë](#)

[**SYRI TV/ Banorët e ish-stacionit të trenit në Elbasan: Nuk kemi infrastrukturë, problem mbetet edhe ndriçimi**](#)

[Kronikë](#)

[**Krujë - Zjarret rikthehen në Halil dhe Krastë, Kalaja: Banorët po luftojnë vetë me flakët**](#)

[Kronikë](#)

[**SYRI TV/ Drejtësia në kolaps, bojkotet paralizojnë gjykatat në Tiranë dhe rrethe**](#)

[Kronikë](#)

[**Fier/ Katër vatra zjarri në pyllin e Semanit, afër grykëderdhjes, flakët përhapen me shpejtësi**](#)

[Kronikë](#)

[**Lezhë/ Flakët në Ungrej po përhapen me shpejtësi drejt zonave të banuara! Rrezikohet kisha e varrezat**](#)

[Kronikë](#)

[**SYRI TV/ Avokatët bojkotojnë seancat në GJKKO shkak i bojkotit, rregullorja e re e GJKKO**](#)

[Kronikë](#)

[**Velipojë, 68-vjeçari kosovar humb jetën në det**](#)

TË NGJASHME

[Kronikë](#)

[**Kanabis çokollatë nga Kanadaja në Shqipëri nga porti i Durrësit! Sekuestrohen 107 kg, vlera e tregut 1.2 mln euri**](#)

[Kronikë](#)

[**SYRI TV/ Drejtësia në kolaps, bojkotet paralizojnë gjykatat në Tiranë dhe rrethe**](#)

[Kronikë](#)

[**SYRI TV/ Zjarri në Fier, 15 banesa të djegura, dëmshtëpërblimi për fermerët në pikëpyetje**](#)

[Kronikë](#)

[**Futën Ziza Pajazitin në burg - Polici merret i pandehur. Punonjësi: Më urdhëroi shefi i policisë, Sokol Kaçolli**](#)

[Kronikë](#)

[**SYRI TV/ Qukësi kundër bashkimit me Librazhdin, banorët: Mos na largoni shërbimet**](#)

[Kronikë](#)

[**EMRI/ Ekzekutimi barbar për çështje droge/ Identifikohet viktima, bëhet fjalë për një 35-vjeçar shqiptar**](#)

[Kronikë](#)

[**Kukës/ Plagosja me armë në Krumë, vetëdorëzohet 30-vjeçari, i sekuestrohen pistoletat dhe kallashnikovit**](#)

- [Lajme](#)
 - [Web TV](#)
 - [Kuriozitete](#)
 - [Arte & media](#)
 - [Sociale](#)
 - [English](#)
 - [Shëndet](#)
 - [Tjera](#)
- [Politikë](#)
- [Kronikë](#)
- [Ekonomi](#)
- [Kosova](#)
- [Botë](#)
 - [Rajoni](#)
- [Kulturë](#)
- [Shkencë](#)
 - [Teknologji](#)
- [Sport](#)
 - [Botërori 2026](#)
- [Jetë/stil](#)
- [Trashëgimi](#)
 - [Histori](#)
- [Mjedis](#)
 - [Klimë](#)
- [Arkiva](#)

SYRI.net është agjencia më e madhe e lajmeve në Shqipëri, që brenda një kohe të shkurtër është kthyer në lider të informacionit. Në SYRI.net do të gjeni opinionistë më me emër në vendin tonë, investime dhe lajme që nuk do të gjeni diku tjetër. Lajmet në SYRI.net janë prodhim i SYRI.net dhe nuk lejohet marrja e tyre pa një komunikim të mëparshëm me redaksinë. Ju ftojmë të klikoni dhe të na shkruani sa herë që ju mendojnë se duhet. Stafi i SYRI.net

Për informacione info@syri.net, për reklama marketing@syri.net

[Denonco](#)

Merrni lajmet më të fundit nga SYRI.net në çdo moment dhe kudo që të jeni!

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.